VENDIM
Nr.27, datë 20.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i	“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 4.4.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM NELI, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. MINISTRIA E FINANCAVE, në mungesë.
2. KËSHILLI I QARKUT DIBËR, në mungesë.
3. ZYRA E PËRMBARIMIT DIBËR, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Kërkuesi, duke iu referuar nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Organet shtetërore nuk kanë respektuar detyrimin e parashikuar në nenin 142 të Kushtetutës, sipas të cilit organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore.
- Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor për një periudhë prej 10 vjetësh është në kundërshtim me konceptin kushtetues të zgjidhjes së çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni i Kthimit të Pronave Dibër, me vendimin nr.51, datë 24.8.1996, i ka njohur nënës së kërkuesit pronësinë mbi një shtëpi banimi (që sot nuk ekziston) dhe mbi këtë bazë e ka kompensuar me vlerën 1.113.867 lekë.

Meqenëse ky vendim nuk është ekzekutuar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila me vendimin nr.18, datë 20.1.2003 ka vendosur detyrimin e Këshillit të Qarkut Dibër ta kompensojë atë në shumën e mësipërme, duke vendosur gjithashtu që kjo shumë të llogaritet në bazë të koefiçentit të rivlerësimit për zbatim në ditën e ekzekutimit të vendimit. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimet nr.622, datë 15.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1450, datë 15.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në zbatim të vendimit gjyqësor, ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr.107, datë 15.10.2003. Zyra e Përmbarimit Dibër e ka vënë çështjen në lëvizje

nëpërmjet lajmërimeve për ekzekutim vullnetar drejtuar Këshillit të Qarkut Dibër, i cili nga ana e tij është përgjigjur me shkresë, se ka qenë në pamundësi financiare për ekzekutimin e shumës së mësipërme për mungesë të mjeteve monetare. Mbi këtë bazë, Zyra e Përmbarimit Dibër i është drejtuar Ministrisë së Financave për çeljen e fondit përkatës. Ministria e Financave nëpërmjet korrespondencës zyrtare ka vënë në dijeni Zyrën e Përmbarimit Dibër se vendimet gjyqësore që lidhen me detyrime financiare likuidohen nga fondet e miratuara nga institucioni përkatës, pasi më parë të analizohen faktet dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.

Përmbaruesi gjyqësor, me vendimin nr.292, datë 30.12.2005, ka pushuar ekzekutimin e Urdhrit Ekzekutiv nr.107, datë 15.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me arsyetimin se Këshilli i Qarkut Dibër nuk disponon fondin e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ndaj këtij vendimi të përmbaruesit gjyqësor, kërkuesi nuk ka paraqitur ankim. Ndodhur në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kërkon prej saj konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata Kushtetuese çmon se në kuptim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individi mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete.

Gjykata Kushtetuese konstaton se për rastin në shqyrtim, kërkuesi megjithëse i ka pasur në dispozicion, nuk ka shterur mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore. Sipas nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile, kundër vendimit të pushimit të përmbaruesit gjyqësor mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë. Në këto kushte, përderisa nuk është shfrytëzuar ky instrument juridik që ligji i ka lënë në dispozicion kërkuesit për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, çështja nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 134, pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.